



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P.630/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.08.2017 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomikë “Rej” sh.p.k, nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-16736-06-06-2017, me objekt: “*Sistemim – Asfaltim Maliq dhe Njësitë Administrative faza II*”, me fond limit 23.847.556 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 29.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

**Ankimues:**

“Rej” shpk  
Banesë private pranë ish zyrave të Komunës Udenisht,  
Pogradec

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Maliq  
Adresa: Bulevardi “Rinia”

**Baza Ligjore:**

*Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I


Vlerësimi paraprak

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se operatori ekonomik ankimues ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.4. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.



Rrethanat e çështjes

I. Në datën 07.06.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-16736-06-06-2017, me objekt: “Sistemim – Asfaltim Maliq dhe Njësitë Administrative faza II”, me fond limit 23.847.556 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 29.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

II.1. Në datën 29.06.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.2. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, me shkresën 4128 prot., datë 08.08.2017 protokolluar me tonën me nr. 1348/2prot., datë 10.08.2017 me objekt: “Dërgohet Informacion”, rezulton se në datën 11.07.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Nika	15.873.033	skualifikuar
- BOE Artyka II&Sireta 2F	16.565.610	skualifikuar
- Rej	17.490.109	skualifikuar
- Shamo Construction	17.965.750	skualifikuar

- BOE Egland &BEIS	17.997.190	skualifikuar
- Hastoci	18.131.440	kualifikuar
- Fled	18.304.405	skualifikuar
- Sark	18.543.710	skualifikuar
- Alb Korça 2002	18.503.530	kualifikuar
- Shendelli	19.159.178	skualifikuar
- Kacededja	21.570.694	kualifikuar
- Aurora Konstruksion	20.654.300	skualifikuar

II.3. Në datën 11.07.2017 operatori ekonomik “Rej” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

1. *Autoriteti Kontraktor, Bashkia Maliq, ne DST pika 8, kerkon qe shoqeria te paraqese certifikata ISO te vlefshme. Certifikatat ISO 14001:2004 dhe 18001:2007 kane skaduar qe prej dates 27.05.2016.*
2. *Per teknikun e ndertimit, Z.Yllson Beqirllari ,operatori nuk ka paraqitur kontrate dhe as diploma te shkolles se mesme apo certifikata te tjera ekuivalente me te.*

II.4. Në datën 18.07.2017 operatori ekonomik “Rej” sha ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

[...]

*Në datën 11.07.2017 jemi njoftuar nëpërmjet spe për vlerësimet e ofertave pjesmarrëse në këtë procedurë prokurimi.[...]*

*Vëmë re se në kundërshtim me nenet 46;53 të LPP-së të ndryshuar oferta e paraqitur nga shoqëria jonë është skualifikuar [...]*

*Bazuar në nenin 63 pika 1 të LPP-së[...], si dhe nenit 63 pika 2 të LPP-së[...]*

*Duke qënë se kemi bindjen e thellë se vendimi i mësipërm është tërësisht i pabazuar dhe jo në përputhje me LPP-në po paraqesim ankesën tonë:*

*Në lidhje me arsyen e skualifikimit të ISO-t pretenduara nga autoriteti juaj kontraktor janë të skaduara dhe të pavlefshme në momentin e dorëzimit të ofertës sqarojmë se:*

*Në dst është parashikuar:*

1. *Shoqeria duhet të paraqesë Çertifikata ISO te vlefshme:*
  1. *ISO 9001- 2008 (Sistemi i menaxhimit te cilesise).*
  2. *ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit te mjedisit).*
  3. *OHSAS 18001-2007(Sistemi i menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune).*
  4. *PASS 99:2012 (Sistem i integruar i menaxhimit).*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO te kerkuar ne gjuhen shqip.*

Referojmë nenin 46 pika 2 e LPP-së, në plotësimin e kriterit të sipërcituar shoqëria jonë ka dorëzuar certifikat ISO 14001 DHE 18001 të lëshuara nga shoqëria certifikuese RIG CERT ku konstatohet menjëherë se këto të fundit janë lëshuar më 28.06.2017 dhe janë të vlefshme deri më 27.06.2020. Sa më sipër ak-ja nuk mund të kufizohet në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave vetëm tek dy ISOT e paraqitura nga shoqëria akredituese Ring Cert Ind të cilat është e vërtetë se kanë përfunduar afatin e vlefshmërisë, por duhet të vlerësojë në tërësi dokumentacionin e kërkuar ku lehtësisht parashikohet se këto të fundit janë paraqitur edhe dy certifikata ISO të së njëjtës kategori ( standard 14001 dhe 18001) të lëshuara në datën 28.06.2017 dhe të vlefshme si në momentin e dorëzimit të ofertave edhe gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Referojmë nenin 46 pika 1 e LPP-së nenin 53 pika 3 e LPP-së,

Sa më sipër me anë të dokumentacionit të dorëzuar provohet ehtësisht se shoqëria jonë disponon certifikatat ISO të pretenduara sit ë pavlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.

Në lidhje me pretendimin e AK-së se nuk janë dorëzuar diploma dhe kontrata e punës e punonjësit të kualifikuar teknik ndërtimi:

Në dst është kërkuar:

2. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 3( tre) punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- 2 Punonjës karpentier me kualifikime teknike nga IQT ose ekuivalente.
- 1 Teknik Ndertimi me kualifikime teknike nga IQT ose ekuivalente.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

- kontrata e punës e vlefshme;
- deshmitë e kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente,
- të figurojnë në listpagesat e shoqërisë
- Diplome e shkolles se mesme profesionale ose diplome e leshuar nga Drejtoria e Formimit Profesional. ( per profesionin, teknik ndertimi)

Për plotësimin sa më sipër shoqëria jonë ka dorëzuar :

certifikatë lëshuar nga HTM për teknikun e ndërtimit Ylson Beqirllari

Referojmë nenin 46 pika 1 c të LPP-së, nenin 26 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014; nenin 46 pika 1 gërma c e LPP-së . Në lidhje me pretendimin e sipërcituar se mungon kontrate punë, sqarojmë se autoriteti juaj kontraktor lehtësisht mund të verifikojë se në listëpagesat e shoqërisë tonë punonjësi i mësipërm figuron si pjesë e stafit teknik të shoqërisë. Sa më sipër nënvizojmë se vijueshmëria e mardhënieve të punës me specialitetin e sipërcituar lehtësisht vihet re edhe nga pagimi i rregullt i detyrimeve që rrjedhin nga mardhëniet e punësimit. Për shkak të problemeve të shfaqura në sistemin e prokurimeve shoqëria jonë për shkaqe të pavarura nga kjo e fundit nuk ka mundur të ngarkojë kontratën e punës dhe diplomës, por këto janë dy dokumenta që jo vetëm janë në historikun e shoqërisë tonë por njëherazi provohen lehtësisht pasi janë dorëzuar edhe në më shumë procedura të mëparshme pranë të njëjtin autoritet kontraktor madje me të njëjtën trupë vlerësimi. Referojmë neni 53 pika 4 e ligjit, Sa më sipër për sa kohë që provohet marrëdhënia e punësimit mes specialistit dhe shoqërisë dhe gjithashtu në kemi dorëzuar me kohë dokumentacionin mbi këtë inxhinier pengesa e mësipërme e ardhur për shkak të mosfunksionimit të APP-së konsiderohet një devijim i vogël i cili nuk ndryshon thelbin dhe

*karakteristikat e ofertës tonë (specialist gëzon kontratë pune në përputhje me nenin 21 të KP si dhe njëherazi i cili gjendet në arkivën e institucionit tuaj për procedurat e tjera të prokurimit. Ndaj për një shqyrtim të drejtë dhe ligjor të pretendimeve tona gjeni kontratën e punës dhe diplomën e inxhinierit. Sa më sipër kërkojmë pranimin e ankesës dhe kualifikimin e shoqërisë sonë.[....]*

II.5. Në datën 26.07.2017 me anë të shkresës nr.3828 prot., datë 21.07.2017 ankimuesi është vënë në dijeni lidhur me pranimin pjesërisht të ankesës sa i takon arsyes së parë (për pika 8, *kerkon qe shoqeria te paraqese certifikata ISO te vlefshme*)konkretisht citoj:[...] Për kërkesën e mësipërme komisioni verifikoi dokumentat e futura në sistem përkatësisht ISO 14001-2015 (sistemi i menaxhimit të mjedisit) dhe OHSAS 18001-2007 (sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë), ato figurojnë në sistem dhe ju keni të drejtë [...] dhe ka vendosur mospranimin e ankesës lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit (për teknikun e ndertimit,Z.Yllson Beqirllari, operatori nuk ka paraqitur kontratë dhe as diplomë të shkollës së mesme apo certifikata të tjera ekuivalente me të.). Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit argumentimi i KSHA është si vijon: Në pikën 6 të dst-ve kërkohe:

*“1 Teknik Ndertimi me kualifikime teknike nga IQT ose ekuivalente.*

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:*

- *kontrata e punës e vlefshme;*
- *deshmite e kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente,*
- *te figurojne ne listpagesat e shoqërisë*
- *Diplome e shkolles se mesme profesionale ose diplome e leshuar nga Drejtoria e Formimit Profesional. ( per profesionin, teknik ndertimi)”*

*Komisioni verifikoi dokumentat e paraqitura nga ju dhe konstatoi se mungon kontrata e punës dhe diploma e shkollës së mesme apo certifikata ekuivalente për teknikun e ndërtimit, gjithashtu komisioni verifikoi listpagesat nëse tekniku i ndërtimit figuron në to, u konstatua se Z.Y.B. me profesion teknik ndërtimi në listëpagesat duhet të figuronte me kodin e profesioibit 3119.15 “teknik i mesëm ndërtimi”, dhe jo 9312.02 “Punëtor krahu” për sa më sipër komisioni konkludon se ju nuk keni paraqitur dokumentat e duhura që plotësojnë kërkesat e dst-ve, pra mosparaqitja e një dokumenti është kusht skualifikues.[....]*

II.6. Në datën 01.08.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke parashtruar pretendimet si vijon:

[...]

*Në datën 26.07.2017 jemi njoftuar nëpërmjet shërbimit postar mbi vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave i cili e ka pranuar pjesërisht ankesën e shoqërisë tonë në lidhje me arsyen e parë të skualifikimit mbi vlefshmërinë e certifikatave ISO të shoqërisë tonë, por pa ndryshuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duke e lënë të skualifikuar ofertën e shoqërisë tonë vetëm në lidhje me arsyen e parë të skualifikimit. Sa më sipër duke vlerësuar se arsyeja e mësipërme e skualifikimit është në kundërshtim me nenin 46 53 e vijues të LPP-së në zbatim të nenit 63 pika 6 paraqesim ankesën si më poshtë vijon:*

*Mbi arsyen e skualifikimit*

Në lidhje me pretendimin e ak-së se nuk janë dorëzuar diploma dhe kontrata e punës e punonjësit të kualifikuar ju sqarojmë si më poshtë:

3. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 3( tre) punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- 2 Punonjës karpentier me kualifikime teknike nga IQT ose ekuivalente.
- 1 Teknik Ndertimi me kualifikime teknike nga IQT ose ekuivalente.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

- kontrata e punës e vlefshme;
- deshmite e kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente,
- te figurojne ne listpagesat e shoqërisë
- Diplome e shkolles se mesme profesionale ose diplome e leshuar nga Drejtoria e Formimit Profesional. ( per profesionin, teknik ndertimi)

Për plotësimin sa më sipër shoqëria jonë ka dorëzuar

Certifikatë lëshuar nga HTM për teknikun e ndërtimit “Y.B.

Referojmë nenin 46 pika 1 c [...]

Nenin 26 të VKM-së RrPP-së

Në lidhje me pretendimin e sipërcituar se mungon kontrate punë, sqarojmë se autoriteti juaj kontraktor lehtësisht mund të verifikojë se në listëpagesat e shoqërisë tonë punonjësi i mësipërm figuron si pjesë e stafit teknik të shoqërisë. Sa më sipër nënvizojmë se vijueshmëria e mardhënieve të punës me specialitetin e sipërcituar lehtësisht vihet re edhe nga pagimi i rregullt i detyrimeve që rrjedhin nga mardhëniet e punësimit.

Për shkak të problemeve të shfaqura në sistemin e prokurimeve shoqëria jonë për shkaqe të pavarura nga kjo e fundit nuk ka mundur të ngarkojë kontratën e punës dhe diplomës, por këto janë dy dokumenta që jo vetëm janë në historikun e shoqërisë tonë por njëherazi provohen lehtësisht pasi janë dorëzuar edhe në më shumë procedura të mëparshme pranë të njëjtin autoritet kontraktor madje me të njëjtën trupë vlerësimi.

Sqarojmë para KPP-së se gjykimin e çështjes në fjalë duhet të marrë në konsideratë faktin se nuk ndodhet para një rasti të përgjithshëm ku një oe për arsye të ndryshme dështon të dorëzojë në spe një dokumentacion të caktuar për qëllime kualifikimi. Në rastin konkret shoqëria jonë me po të njëjtin autoritet dhe të njëjtën KVO si një shoqëri që shfaq interes për procedurat e zhvilluara nga Bashkia Maliq ka dorëzuar disa herë në vijimësi të njëjtën kontratë pune dhe dëshmi kualifikimi së bashku me diplomën profesionale të lëshuar nga organet kompetente për punonjësia Y.B.

Madje po në këtë procedurë prokurimi autoriteti kontraktor referuar edhe arsyes së skualifikimit ka vet identifikuar faktin se Y.B. është tekniku i ndërtimit dhe është pikërisht ai për të cilin ka mangësi dokumentacioni. Referojmë neni 53 pika 4 e ligjit, Sa më sipër për sa kohë që provohet marëdhënia e punësimit mes specialistit dhe shoqërisë dhe gjithashtu ne kemi dorëzuar me kohë dokumentacionin mbi këtë inxhinier pengesa e mësipërme e ardhur për shkak të mosfunksionimit të APP-së konsiderohet një devijim i vogël i cili nuk ndryshon thelbin dhe karakteristikat e ofertës tonë (specialist gëzon kontratë pune në përputhje me nenin 21 të KP si

dhe njëherazi i cili gjendet në arkivën e institucionit tuaj për procedurat e tjera të prokurimit.  
[...]

Vet KSHA referuar kthimit të përgjigjes ndër të tjera ka pranuar në heshtje faktin se KVO dhe KSHA dhe në tërësi autoriteti kontraktor disponon dokumentacion të plotë në lidhje me teknikun e sipërcituar gjithashtu ka konstatuar se Y.B. është teknik ndërtimi por ka refuzuar duke ngritur pretendimin shtesë me argumentimin se: U konstatua se Z.Y.B. me profesion teknik ndërtimi në listëpagesat duhet të figuronte me kodin e profesioibit 3119.15 “teknik i mesëm ndërtimi”, dhe jo 9312.02 “Punëtor krahu” për sa më sipër komisioni konkludon se ju nuk keni paraqitur dokumentat e duhura që plotësojnë kërkesat e dst-ve. Në lidhje me pretendimin e mësipërm së pari sqarojmë se Kodi i Punonjësve përcaktohet me anë të VKM-së nr. 629 datë 11.06.2009 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve” VKM-ja e mësipërme është një vendim i dalë në zbatim të ligjit për arsimin profesional të ndryshuar , por në asnjë rast kodi i profesionit i deklaruar në listëpagesat e shoqërisë nuk përcakton nivelin e kualifikimit apo llojin e kualifikimit të punonjësit. Gjithashtu nënvizojmë se arsyeja e mësipërme është pretendim i ri shtesë. KSHA i ka kompetencat e kufizuara madje përcakton qartë neni 63 pika 2;3;5 i LPP-së si dhe rregullim specifik neni 78 “Shqyrtimi i Ankesave”[...]

Sa më sipër mendojmë se KSHA ka tejkaluar kompetencat e saj në lidhje me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave duke marrë rolin e KVO-së duke ngritur pretendime të reja shtesë për skualifikimin e ofertës tonë me reteksin e ri se specialisti Y.B. figuron në listëpagesa me një kod të ndryshëm nga kodi i profesionit që duhet të figuronte dhe kjo së fundmi nuk e plotëson kriterin e kualifikimit. Megjithatë për të shqyrtuar pretendimet tona dhe për të njohur dhe krijuar bindjen e plotë se specialisti Y.B. disponon të gjitha kualifikimet e nevojshme , kontratën e punës dhe dëshminë e kualifikimit/diplomën e lëshuar nga organet kompetente po ju vëmë në dispozicion bashkëngjitur dokumentacion që e kemi dorëzuar rregullisht pranë autoritetit kontraktor Bashkia Maliq në procedurat e tjera të tenderimit po me anë të sistemit të prokurimeve elektronike, që është i njëjti dokumentacion me atë të vënë në dispozicion edhe KSHA. Ndaj për një shqyrtim të drejtë dhe ligjor të pretendimeve tona gjeni kontratën e punës dhe diplomën e inxhinierit

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.4128 prot., datë 08.08.2017 protokolluar me tonën me nr.1348/2 datë 10.08.2017 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

**Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Rej” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se *“Për teknikun e ndërtimit,Z.Y. B.,operatori nuk ka paraqitur kontratë dhe as diploma të shkollës së mesme apo certifikata të tjera ekuivalente me të”* Komisioni Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 10 *“Kriteret e vecanta të kualifikimit”* pika 6 *“Kapaciteti teknik”* të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 3( tre) punonjës të kualifikuar si më poshtë:*

- 2 Punonjës karpentier me kualifikime teknike nga IQT ose ekuivalente.
- 1 Teknik Ndertimi me kualifikime teknike nga IQT ose ekuivalente.

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:*

- kontrata e punës e vlefshme;
- deshmite e kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente,
- te figurojnë ne listpagesat e shoqërisë
- Diplome e shkolles se mesme profesionale ose diplome e leshuar nga Drejtoria e Formimit Profesional. ( per profesionin, teknik ndertimi)

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimues “Rej” shpk në përmbushje të kritereve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- i. *Dëshmi kualifikimi për Y. B.; profesioni teknik ndërtimi lëshuar nga trupë certifikuese HTM shpk*

III.1.3. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur, pretendon se: *“[...] Në lidhje me pretendimin e sipërcituar se mungon kontrate punë, sqarojmë se autoriteti juaj kontraktor lehtësisht mund të verifikojë se në listëpagesat e shoqërisë tonë punonjësi i mësipërm figuron si pjesë e stafit teknik të shoqërisë. Sa më sipër nënvizojmë se vijueshmëria e mardhënieve të punës me specialitetin e sipërcituar lehtësisht vihet re edhe nga pagimi i rregullt i detyrimeve që rrjedhin nga mardhëniet e punësimit.*

*Për shkak të problemeve të shfaqura në sistemin e prokurimeve shoqëria jonë për shkaqe të pavarura nga kjo e fundit nuk ka mundur të ngarkojë kontratën e punës dhe diplomës, por këto janë dy dokumenta që jo vetëm janë në historikun e shoqërisë tonë por njëherazi provohen lehtësisht pasi janë dorëzuar edhe në më shumë procedura të mëparshme pranë të njëjtin autoritet kontraktor madje me të njëjtën trupë vlerësimi.*

*Sqarojmë para KPP-së se gjykimin e çështjes në fjalë duhet të marrë në konsideratë faktin se nuk ndodhet para një rasti të përgjithshëm ku një oe për arsye të ndryshme dështon të dorëzojë në spe një dokumentacion të caktuar për qëllime kualifikimi. Në rastin konkret shoqëria jonë me po të njëjtin autoritet dhe të njëjtën KVO si një shoqëri që shfaq interes për procedurat e zhvilluara nga Bashkia Maliq ka dorëzuar disa herë në vijimësi të njëjtën kontratë pune dhe*



dëshmi kualifikimi së bashku me diplomën profesionale të lëshuar nga organet kompetente për punonjësin Y.B.[...]

III.1.4. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues argumenton se: “[...]Në pikën 6 të dst-ve kërkohet:

“1 Teknik Ndertimi me kualifikime teknike nga IQT ose ekuivalente.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

- kontrata e punës e vlefshme;
- deshmite e kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente,
- te figurojne ne listpagesat e shoqërisë
- Diplome e shkolles se mesme profesionale ose diplome e leshuar nga Drejtoria e Formimit Profesional. ( per profesionin, teknik ndertimi)”

Komisioni verifikoi dokumentat e paraqitura nga ju dhe konstatoi se mungon kontrata e punës dhe diploma e shkollës së mesme apo certifikata ekuivalente për teknikun e ndërtimit, gjithashtu komisioni verifikoi listpagesat nëse tekniku i ndërtimit figuronte në to, u konstatua se Z.Y.B. me profesion teknik ndërtimi në listëpagesat duhet të figuronte me kodin e profesioibit 3119.15 “teknik i mesëm ndërtimi”, dhe jo 9312.02 “Punëtor krahu” për sa më sipër komisioni konkludon se ju nuk keni paraqitur dokumentat e duhura që plotësojnë kërkesat e dst-ve, pra mosparaqitja e një dokumenti është kusht skualifikues.[....]

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.1.6. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

III.1.7. Në nenin 26, pika 8 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*".

III.1.8. Sa më sipër analizuar, konstatohet se vetë operatori ekonomik ankimues, pranon se, për teknikun e ndërtimit, nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kriteret për kualifikim, vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues "Rej" shpk mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur*" me Nr.REF-16736-06-06-2017, me objekt: "*Sistemim – Asfaltim Maliq dhe Njësitë Adminsitrative faza II*", me fond limit 23.847.556 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 29.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 "*Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

## **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Rej" sh.p.k. për procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur*" me Nr.REF-16736-06-06-2017, me objekt: "*Sistemim – Asfaltim Maliq dhe Njësitë Adminsitrative faza II*", me fond limit 23.847.556 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 29.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.1348 Prot; Datë 01.08.2017**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

